VENDIM
Nr.724, datë 5.11.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.198, DATË 4.5.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.198, datë 4.5.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Objekt i veprimtarisë së Entit Kombëtar të Banesave është financimi, ndërtimi dhe shitja e banesave në kushtet e konkurrencës së lirë, për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimin e veprimtarisë, për mbështetjen e politikave sociale të strehimit dhe për sigurimin e banesave me kosto të ulët, në përputhje me ligjin nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet e strehimit të banorëve të zonave urbane"."

2. Shkronja "f" e pikës 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"f. Blerje trojesh nga subjekte publike apo private, për ndërtimin e banesave të paracaktuara për t'u shitur në tregun e lirë.".

3. Pas shkronjës "h" të pikës 2, shtohen shkronjat "i", "j", dhe "k", me këtë përmbajtje:

"i. Hyn në marrëveshje bashkëpunimi me subjekte publike apo private për realizimin e projekteve me interes të përbashkët.

j. Ndërton banesa me kosto të ulët dhe i shet ato me kredi, me kushte lehtësuese, për familjet, që kanë nevojë për strehim, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore në fuqi.

k. Në rastet kur, sipas lejes së dhënë nga organet përkatëse, parashikohet ndërtimi i mjediseve për zyra ose shërbime, në katet e para të objekteve të banimit kryen shitjen e tyre në tregun e lirë.".

4. Pas paragrafit të katërt të pikës 3, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Këshilli drejtues, përveç kompetencave të njohura nga ligji nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", të ndryshuar, dhe ato të përcaktuara në statutin e tij, ka edhe këto kompetenca:

a) I propozon Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit kandidaturën e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Entit Kombëtar të Banesave;

b) Miraton marrëveshjet sipas shkronjës "i" të pikës 2 të vendimit;

c) Miraton përdorimin e të ardhurave të siguruara nga veprimtaria e Entit Kombëtar të Banesave në tregun e lirë, për programet sociale të banesave me kosto të ulët, sipas akteve ligjore në fuqi dhe në bazë të analizave ekonomiko-financiare të hartuara nga ky ent;

ç) Miraton kriteret e përcaktimit të punonjësve, që përfitojnë strehim, nëpërmjet të ardhurave të Entit Kombëtar të Banesave, në njërën nga format e mëposhtme:

- kredi për strehim;
- shitje të pronës me rezervë për blerje banese nga tregu;
- banesë me vlerën e kostos, në objektet e banimit, që ndërton Enti Kombëtar i Banesave, për t'i shitur në tregun e lirë.".

5. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano